

# KONCEPTE REGJISORIALE

MBI KOMEDINË

## PREFEKTI

Driada DERVISHI

Prefekti është një komedi me tri akte, e shkruar nga autori dhe aktori elbasanas Besim Levonja (1922–1968). Kjo vepër nisi si skeç gjatë periudhës së teatrit partizan (1942–1944). Teksti mori një formë dramaturgjike të plotë katër vite pas çlirimit të Shqipërisë (1948), vit kur dhe u vu për herë të parë në skenë në Teatrin Popullor.

Duke e krahasuar me të gjitha komeditë e tjera të shkruara e të vëna në skenë gjatë periudhës së sistemit komunist, por edhe pas tij, Prefekti shënon si numrin më të madh të vënieve, po ashtu edhe jetëgjatësinë më të madhe në repertorin e teatrit shqiptar: nga viti 1948 deri në vitin 1982.<sup>1</sup>

Nga ana tjetër, ky tekst letrar, me të drejtë është “vepra e parë e rëndësishme nga fusha e dramës e shkruar menjëherë në vitet e para të pas Luftës së Dytë Botërore”. Nga aspekti struktural dhe tipologjik teksti është i bazuar mbi elemente të komedisë së karaktereve dhe situatave, ku mbizotërojnë elementët e komedisë së karakterit.<sup>2</sup>

Në këtë tekst personazhi kryesor nuk është produkt i trillimit artistik, por është ish prefekti i Tiranës gjatë kohës së pushtimit fashist (1939–1942), Qazim Mulleti (1893–1956) që në vepër, ashtu si gjithë familja e tij dalin me emra realë. Personazhi

1 Arkiva e Teatrit Kombëtar, Tiranë.

2 Rexhaj, Besim. Drama Shqiptare pas luftës së Dytë Botërore 1948-2008. Prishtinë, ShB Faik Konica, 2009, f. 211-214.

artistik njëjtësohet me një person historik, madje e superon atë duke u ngulitur në kujtesën e publikut.

Suksesi i kësaj komedie në dy kontekste historike të ndryshme, në periudhën e diktaturës dhe sot e kësaj dite, mund të shpjegohet me tre momente:

1. teksti dramatik me strukturën e tij;

2. konceptet regjisoriale, secili me këndvështrimin përkatës;

3. individualiteti i fuqishëm i tre aktorëve të mëdhenj të teatrit shqiptar: Mihal Popi (1909–1979), Nikolin Xhoja (1926–1987), Robert Ndrenika (1942), të cilët sollën në skenën tonë, tre prefektë të ndryshëm.

Nëse teknika skenike e aktorit, siç thotë Grotovski, është baza e teatrit, atëherë përzgjedhja e këtyre aktorëve (secili me një teknikë origjinale të tijën), ka sjellë bazën e një shfaqjeje të suksesshme.

## Historiku i vënieve në skenë

Prefekti u shfaq për herë të parë më 11 dhjetor 1948 në Teatrin Popullor Tiranë (sot Teatri Kombëtar). Kjo ishte premiera e 32-të e Teatrit Popullor, dhe e dyta nga dramaturgjia, pas Dom Gjonit, me shumë akte.<sup>3</sup> Komedia u vu si bashkëpunim regjisorial midis regjisorit Andon Pano (1921–1993), i specializuar për teatër në Rusi dhe nga regjisori rus A. I. Kriçko. Në rolin e Prefektit luante aktori Mihal Popi, ndërsa në rolin e bashkëshortes së tij Hajries, ndër aktoret e para të teatrit, Behije Çela.

---

3 Pano, Andon. "Pavarësisht nga renditja kronologjike". Drita, nr. 1332 (maj 1986). Tiranë, f. 12.

Mitrush Popi luajti në rolin e Reshimit. Man Kukaleshi, spiuni dhe krahu i djathtë i Prefektit u luajt për herë të parë nga Gjon Karma, (rol të cilin ai e luajti në të gjitha vëniet e Prefektit). Bukurija, shërbëtorja, nga aktorja e njohur Marika Kallamata, në atë kohë vetëm 18 vjeçe, ndërsa portieri i Qazimit, Aliu, nga Xhevat Serezi. Loro Kovaçi, aktiviteti teatror i të cilit kishte nisur që në vitet '20, merr rolin e tij të parë si aktor profesionist në Teatrin Popullor, me Veliun, kapterin. Hysen Aga u luajt nga aktori i madh Sulejman Pitarka, ndërsa djali i tij nga Viktor Gjoka. Katerina, gruaja e doktorit vjen nga aktorja korçare, Vangjeli Pikuli. Sandër Prosi, një prej aktorëve më të mëdhenj shqiptar, gjithashtu interpreton për herë të parë në teatër me rolin e Shaqir Agës. Tef Pali dhe Luan Qerimi (dublant) në rolin e Sadikut. Kafexhiu, luhet nga aktori i njohur i roleve të vegjël, Ndrek Shkjezi.

Rolet e qytetarëve u luajtën për herë të parë nga tre aktorë të shquar shqiptarë: Ndrek Luca, Naim Frashëri dhe Marije Logoreci. Në rolet e katundarëve: Prokop Mima, Ilia Shyti dhe Lazër Vlasi.

Katër muaj më vonë, më 15 prill 1949, kjo komedi vihet në Teatrin e Durrësit nga regjisori amator Vlash Beçka. Aktori Nikolin Xhoja ishte në rolin kryesor, e në rolin e Hajries, bashkëshortja e tij, Meropi Xhoja. Liu – Todi Thanasi.

Katër vjet më vonë, me rastin e krijimit të Teatrit "Aleksandër Moisiu" në janar të vitit 1953, komedia vihet në skenë dhe futet në repertorin aktiv të këtij teatri. Kësaj radhe regjisor është Panajot Kola, i cili sapo kishte përfunduar studimet për teatër në Rusi.

Në të dy vëniet në këtë teatër, 80% e trupës ishte amatore. Në harkun kohor të gati njëzet e pesë viteve, që shkon saktësisht deri në vitin 1973, në teatrin "A. Moisiu" janë luajtur 130 shfaqje.<sup>4</sup> Ndërkaq, në prill të vitit 1969, pas 11 vjetësh (ndërkohë ajo ishte futur herë pas here në repertorë të sezoneve të ndryshëm deri në 1959<sup>5</sup>), komedia rikthehet në Teatrin Popullor, me një

4 Arkiva e Teatrit "Aleksandër Moisiu", Durrës.

5 Arkiva e Teatrit Kombëtar, Tiranë.

trupë pothuaj të njëjtë me vënien e parë, nga ku ndjehet më shumë pjekuria artistike. Regjisori Andon Pano bashkëpunon në këtë vënie me piktorin R. Dabërdaku. I identifikuar me këtë personazh, që nga fillimet e teatrit partizan, aktori Mihal Popi është sërish në rolin e Prefektit. Kemi shumë pak ndryshime në trupë, si: Mario Ashiku zë vendin e Loro Kovaçit, për rolin e Velikut; i biri Hysen Agës, studenti, këtë herë interpretohet nga aktori dhe regjisori Dhimitër Pecani. Në rolet e policëve, që shtohen në këtë vënie, kemi: Ilia Shytin, Vladimir Priftin dhe Fatos Haxhirajn. Shiti, i biri, luhet nga dy dublantë: Hasan Muka e Piro Sotiri. Është interesant fakti që në fletëpalosjen që shoqëron këtë vënie shënohen të gjithë emrat e stafit teknik: që nga inspektori i skenës, Avni Resuli, e deri te këpucari.<sup>6</sup>

Prefekti vjen me një variant të ri vetëm pas katër vitesh. Me rastin e Festës së Pavarësisë në vitin 1973, Prefekti tërheq një nga regjisorët më të shquar të teatrit shqiptar, Pirro Mani, së bashku me Tef Palin. Në rolin e Prefektit vihen tre aktorë dublantë: Sulejman Pitarka (artist i merituar në atë kohë), Xhemil Tagani dhe një aktor që në atë kohë ishte 35 vjeç dhe që identifikohet dhe sot e kësaj dite me këtë figurë: Robert Ndrenika. Kjo vënie qëndroi në repertorin e Teatrit Popullor për gati 10 vjet rresht. Kasti i aktorëve në këtë variant të tretë kishte në përbërjen e tij gati 40% të trupës së vënieve të mëparshme: ku vazhdon që prej vitit 1948 në rolin e Hajries, aktorja Behije Levonja (Çela) dhe pse e dubluar nga Marika Kallamata; një aktor tjetër që e luajti si për herë të parë e deri në fund Man Kukaleshin, identifikohet dhe sot shpesh me këtë rol: Gjon Karma. Sandër Prosi këtë herë kalon në rolin e Aliut, ndërsa Ndreka Shkëzezi, nga roli i kafexhiut në vënien e parë, kalon në rolin e Velikut, kapterit. Prokop Mima në rolin e Hasan Agës, Ilia Shyti kalon në rolin e Memecit dhe Kafexhiu këtë herë luhet nga Lazër Vlasi.

---

6 Po aty. Fletëpalosje e shfaqjes.

Për pjesën tjetër të trupës u përzgjedhën aktorë të cilët ishin afirmuar ndërkohë e që po krijonin brezin e ri të aktorëve më të mirë shqiptarë si: Agim Qirjaqi në rolin e Sadikut, Pavlina Mani dublante me Esma Agollin në rolin e Katerinës, Roland Trebicka në rolin e të birit të Hasan Agës, Anastas Kristofori në rolin e Sekretarit, i dubluar nga Petraq Xhillari; Bujar Lako dhe Fatos Haxhiraj në rolin e katundarëve. Lazër Filipit i jepet roli i Shaqir Agës, ndërsa në rolet e qytetarëve: Besa Imami, Pandi Siku, Pirro Malaveci. Në rolin e Shitit, Leonard Deliu. Muzika nga Kozma Laro, me skenografi e kostumografi nga Hysen Devolli. Komedia Prefekti deri në vitin 1980 është dhënë në Tiranë 174 herë dhe është ndjekur nga 74.685 spektatorë.<sup>7</sup> Prefekti, që prej vitit 1982, nuk është shfaqur më në teatër, por realizmi i variantit të tij të tretë, për nga shikueshmëria në televizion, klikime ne Youtube si dhe shitje të kasetave, renditet njësoj me filmin Kapedani dhe komedinë Pallati 176.<sup>8</sup>

## Figura historike kundrejt figurës artistike

Figura historike në qendër të komedisë Prefekti është Qazim Mulleti, i lindur nga një familje tiranase. Ai ishte poliglot: dinte turqisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, latinisht, serbo-kroatisht dhe greqisht. Hobi i tij ishte hipizmi, koleksionimi i suvenirëve, – ku në shtëpinë e vet, një kat e kishte shndërruar në muze të posaçëm, – si dhe patinazhi në akull. Në 1912-n, merr pjesë në ngritjen e flamurit në Tiranë dhe Vlorë. Në 1914-n është një ndër katër adjutantët e Princ Vidit. Largohen së bashku në Vjenë, ku jetoi deri në vitin 1920. Aty, Qazim Mulleti vijoi studime specializimi shtesë në fushën e diplomacisë ushtarake të luftës. Në vitin 1920 merr pjesë në Kongresin e Lushnjës. Shumë patriotë të Tiranës hapën shtëpitë e tyre në dispozicion të qeverisë së re të dalë nga Kongresi i Lushnjës.

---

7 Po aty.

8 <https://www.facebook.com/notes/kinematografia-shqiptare/roli-i-jetes-rol-i-prefektit/528147220578484/>. Parë më 20 dhejtor 2018.

Një shtëpi e Mulletëve u bë Ministria e parë e Bujqësisë. Në shtator të vitit 1920, është Komandant i Forcave Vullnetare kundër Serbisë. Më 25 prill–3 maj 1921, ai merr pjesë në Kongresin për Bashkimin Kombëtar në Vlorë, si përfaqësues i Tiranës.

Në Qeverinë e Sulejman Delvinës dhe Fan Nolit, pati një detyrë të rëndësishme, si prefekt në Dibër. Mbas dështimit të Revolucionit largohet nga Shqipëria. Në fillim vendoset në Zara të Jugosllavisë, ndërsa më vonë në Vjenë, ku ndenji si emigrant politik deri në vitin 1931. Kur ishte në Vjenë, pikërisht në vitin 1929, ai martohet me Hajrie Kusin, me të cilën pati vetëm një djalë. Në muajin korrik të vitit 1939, disa muaj pas largimit të mbretit Zog, Qazim Mulleti kthehet nga emigrimi, ndërsa në Durrës e presin me dhjetëra njerëz të njohur. Emërohet Prefekt i Tiranës dhe kryen këtë detyrë nga viti 1939 deri në vitin 1942. Emigron në Itali, ku dhe vdes, tre muaj përpara ardhjes në pushtet të Partisë Komuniste në Shqipëri.

Pushteti i sapovendosur, nxiti krijimin e veprave dhe shfaqjeve teatrore në funksion të propagandës së tij. Jo vetëm pushtuesit, por edhe kushdo që kishte shërbyer në administratën e regjimit të kaluar, ata që kishin origjinë klasore “jo proletare”, u trajtuan në një këndvështrim grotesk e anadollak nga kjo klasë e re. Në këtë frymë u trajtua dhe komedia Prefekti. Karakteristikat e personazhit që ne shohim në veprën artistike janë diametralisht të kundërta nga njeriu real që përmendëm më sipër. Nga njëra anë kemi personazhin historik real, Qazim Mulleti, një njeri i kulturuar, me shumë gjuhë të huaja e medalje ari në universitete evropiane, që ka ndihmuar për formimin e shtetit të parë shqiptar e, nga ana tjetër, personazhi artistik na paraqet një Prefekt të trashë, injorant, me zakone prapanike, mendjeshkurtër e matrapaz, që luan në kurriz të popullit.

Në arkivin e Teatrit Kombëtar, në fletëpalosjen që promovonte shfaqjen e vitit 1973, shkruhet: “Komedia Prefekti e Besim Levonjës, satirizon dhe vë në lojë një nga armiqtë më të tërbuar të popullit tonë, shërbëtorit dhe sahanlëpirësit të okupatorit, Qazim Mulleti.”<sup>9</sup> Kritika e kohës, por edhe ajo

9 Arkiva e Teatrit Kombëtar, Tiranë. Fletëpalosje e shfaqjes.

pas viteve '90 mbështet faktin se: "Prefekti i Qazim Mulletit është mishërim i humorit tonë, konflikteve familjare, tarafeve, allishverisheve e tolerancës. Kjo penë e artë që i fali popullit të tij një kryevepër të vërtetë të humorit dhe satirës, njëherazi përjetësoi dhe e bëri të pavdekshëm Prefektin e Tiranës të atyre viteve, Qazim Mulletin."<sup>10</sup>

Vepra artistike është një trillim, dhe vetë autori Besim Levonja me të drejtë i përgjigjet Reshitit, djalit të Qazim Mulletit të vërtetë, pasi ky i fundit sheh shfaqjen: "Ajo është komedi, Reshit, dhe aty mund të ngacmohet kushdo. Sot ndoshta nuk e kupton, por më vonë do të më japësh të drejtë."<sup>11</sup> Megjithatë ka shumë mendime që kundërshtojnë njëri-tjetrin në lidhje me figurën kryesore të kësaj komedie. Fakti është se nuk ndodh shpesh që në një vepër artistike të bëhen personazhe emrat realë të një familjeje të tërë. Duke u mbështetur te trillimi, këtij fakti nuk do t'i kushtohet shumë rëndësi, nëse fati i jetës së këtyre familjarëve nuk do të ishte aq tragjik. Pasi Enver Hoxha e pa këtë pjesë, dërgoi në internim si të shoqen e Qazim Mulletit, Hajrien, ku dhe ajo vdes, ashtu dhe djalin e tij të vetëm, Reshitin. "Gjenialisht e mizorisht si është shkruar, përmban një përtallje masive, të organizuar nga shteti i diktaturës. Kjo përtallje iu bë familjarisht, personazhit kryesor Qazim Mulletit, me emrat realë të bashkëshortes dhe të djalit të vetëm. Akuza për përqeshjen politike kundër familjes Mulleti që vijoi gjer në ditën e grahmës së fundit të diktaturës 'proletare', i kalon kufijtë duke e çuar madje në krim këtë për vetë faktin se fill pas kësaj shfaqjeje, i biri dhe e shoqja e Qazim Mulletit, u dërguan në kamp internimi ku qëndruan për 45 vjet rresht."<sup>12</sup> Edhe personazhi i Hajries, pëson të njëjtin transfigurim nga ai real i dhe ai skeniku. Nëse Hajria, bashkëshortja e vërtetë e Qazim Mulletit, ishte ndër të parat vajza shqiptare, e cila studioi në Konservatorin Francez në Paris, në vepër kemi një personazh që nuk di si kapet telefoni.

---

10 Laze, Luan. "Besim Levonja, pena e artë e Prefektit". Tirana Observer, nr.3560 (janar 2012). Tiranë, f. 8.

11 Po aty.

12 Polovina, Ylli. "Qazim Mulleti, i persekutuari edhe me një komedi": <http://www.yllipolovina.com/index.php?page=news&news=699>. Parë më 17 prill 2019.

Reshit Mulleti i vërtetë, Shiti siç njihet në komedi, ka qenë vetëm 14 vjeç kur është ndarë përgjithmonë nga i ati. Ai kujton për të se: "Ai ishte njeri i thjeshtë, serioz, i ditur."<sup>13</sup> Aktori që vazhdon ta përcjellë Prefektin edhe pas viteve 2000, Robert Ndrenika thotë: "Më duhet t'u kërkoj falje dy personave: gruas dhe djalit të Qazim Mulletit. Që të dy ata panë një kalvar të padrejtë vuajtjesh dhe padrejtësish nëpër internimet."<sup>14</sup>

Deri dje trajtimi i figurës bëhej në bazë të ideologjisë dhe politikës së kohës<sup>15</sup>, sot kjo figurë shihet si përfaqësues i një kategorie apo shtrese të caktuar njerëzish. Shndërrimi i gjuhës, karaktereve, kuptimeve që përcjell vepra, tanimë mbeten vetëm brenda kufijve të teatrores.

Figura artistike është kthyer vetiu në një stereotip të zyrtarëve injorantë të asaj kohe dhe kësaj kohe, dhe Prefekti një personazh komedie, me universalitetin e tij, jep mundësi të shumta riinterpretimi.

Robert Ndrenika e përshkruan më së miri këtë fenomen: "Përveç emrit, ai rol ka pak të përbashkëta me personazhin historik. Prefekti, në konceptin tim, ka qenë një pushtetar, i cili ka brenda vetes një karakter popullor që rron edhe sot e kësaj dite.

---

13 Vataj. Albert. "Ja cili është Qazim Mulleti, Prefekti i vërtetë i Tiranës, ai që u denigrua nga diktatura dhe vijon të keqkuptohet edhe sot": <http://albertvataj.com/2016/11/ja-cili-eshte-qazim-mulleti-prefekti-i-vertete-i-tiranes-ai-qe-u-denigrua-nga-diktatura-dhe-vijon-te-keqkuptohet-edhe-sot/>. Parë më 20 dhjetor 2018.

14 Minxhozi, Skënder. "Pse i kërkoj ndjesë familjes së Qazim Mulletit": <http://www.gazetatema.net/2012/10/09/pse-ikerkoj-ndjese-familjes-se-qazim-mulletit/>. Parë më 17 prill 2019.

15 Gjini, Miho. Artisti i popullit Nikolin Xhoja. Tiranë, ShB Edlora, 2015, f.75. Lexo po aty: "Batërdisja e autorit qe ekstreme e me dozat e ashpra të urrejtjes, shkruar pikërisht në flakën e luftës (si skeç, për të dëfryer partizanët në kohën e shlodhjes) dhe më pas, më e plotë, kur Shqipëria qe e çliruar nga të huajt dhe përjetonte euforinë e përgjithshme të të qenit shtet i mëvetshëm e të denoncimit të zyrtarëve kuislingë e të pushtuesve të huaj. Tashmë, edhe pasuesit e këtij regjimi të mundur, duke përfshirë kuislingë, drejtues të të gjitha sferave zyrtare të tipit të Qazim Mulletit, nacionalistë të ndershëm, tregtarë, intelektualë të kulluar, deputetë, bile edhe shkrimtarë e profesorë prestigjiozë, nuk mund të kishin tjetër trajtim, veç atij të talljes më ekstreme, deri në karikaturizimin e tyre, pa përmendur këtu ndëshkimet e egra që pasuan."

Injorancë ka pasur edhe më vonë, në kohën e komunizmit. Madje ka qenë ajo injorancë e disa zyrtarëve, që më frymëzoi edhe për rolin. Ky ka qenë në fakt një tipar i interpretimit tim. Pra që nisesha në rolet e mia, nga psiko-fizika e personazheve të epokës time, me qëllim që ta bëja sa më real dhe të afërt personazhin për publikun e kohës. I qëndroj mendimit se shoqëria njerëzore është e ndërtuar në mënyrë të tillë, që epokat, regjimet dhe sistemet i ngjajnë njëri-tjetrit. Fenomene si ato që dalin tek Prefekti, janë në fakt universale, përtej sistemeve. Pra, edhe kur kam luajtur Prefektin, kisha parasysh aktualitetin. Qazim Mulletit, i njihja vetëm etapat kryesore të jetës, që ishte fanolist, antizogist, më pas kolaboracionist etj. Roli i tij në komedi, ishte ai i një zyrtari kuisling, i cili do me çdo kusht të mbajë një pushtet që e ndjen se po i lëviz.”<sup>16</sup>

Karakterizimi i figurës historike të Qazim Mulletit është përtej këtij punimi, është pjesë e debatit tonë për figurat historike dhe u takon historianëve ta zbulojnë nëse ishte tradhtar, shërbëtor apo sahanlëpirës i pushtuesve. Madje, gjithë kjo përballje personazhesh historikë të shndërruar në personazhe skenike mund të quhet si një faktor, edhe pse minor, për një farë nxitjeje e kurioziteti për ta parë e riparë këtë shfaqje. Përmes figurës artistike të Qazim Mulletit, tashmë të universalizuar, figura e tij historike vazhdon të mbetet në historinë si shqiptare edhe të teatrit. Kjo vepër, edhe pse u krijua brenda një kornize politike, ka skicuar karaktere që vazhdojnë t’i qëndrojnë kohës, dhe që ndoshta, ashtu siç pohon dhe vetë Qazim Mulleti pasi lexon tekstin: “Më paskan bërë nder pasi më kanë bërë të përjetshëm.”<sup>17</sup>

---

16 Minxhozi, Skënder. “Pse i kërkoj ndjesë familjes së Qazim Mulletit”: <http://www.gazetatema.net/2012/10/09/pse-ikerkoj-ndjese-familjes-se-qazim-mulletit/> . Parë më 17 prill 2019.

17 Nergjoni. Bardha. “Komedia Prefekti/Rrëfëhet nipi: Ja pse e denigroi Enver Hoxha, Qazim Mulletin”: <http://opinion.al/komedia-prefekti-rrerefet-nipi-ja-pse-e-denigroi-enver-hoxha-qazim-mulletin/>. Parë më 16 janar 2019.

## Këndvështrimet regjisoriale

I njëjti tekst, regjisorë të ndryshëm, i njëjti rol, aktorë me individualitete të ndryshëm.

Prefekti jo vetëm që është shfaqja me numrin më të madh të replikave në repertorin e teatrit tonë, por edhe shfaqja e cila ka pasuar përveç qindra vënieve në rrethe amatore në mjaft qytete të Shqipërisë, por çka është kryesore ka mbi katër variante zyrtarë, e drejtuar nga 6 regjisorë.

TNë variantin e parë në Tiranë, 1949, pasi Besim Levonja i propozon Mihal Popit se kishte një rol shumë të mirë për të, fillon puna në tavolinë me regjisorin Andon Pano, i cili kishte ndihmuar në krijimin e teatrit partizan si dhe në krijimin e Teatrit të Shtetit më 1945. Pas specializimit të tij në BS (Rusi), ai kthehet në Teatrin Popullor ku është regjisor i mjaft pjesëve dhe luan si aktor. Pjesën e filloi ai ta vinte në skenë, por më pas punën në fazën e dytë e vazhdoi regjisorin rus A. Kriçko. Në kuadër të emancipimit të teatrit profesionist, mjaft regjisorë të Bashkimit Sovjetik erdhën për të dhënë eksperiencën e tyre. Ashtu siç mjeshtëria e aktorit, forma e të mishëruarit të personazhit, ishin në hapat e parë, po ashtu dhe regjisura shqiptare ishte në fazën e parë si art dhe mjeshtëri e nivelit profesionist. Megjithatë duhet thënë se ky bashkëpunim mes një regjisor shqiptar që kishte studiuar në Rusi dhe një regjisor të njohur rus solli një shfaqje që bëri shumë përshtypje. Në Historia e Teatrit Shqiptar nënvizohet: "Në komedinë Prefekti të Besim Levonjës, nën udhëheqjen regjisoriale të Andon Panos dhe regjisorit rus A. Kriçko shkëlqeu loja aktoriale e Mihal Popit në rolin e Qazim Mulletit, sikurse kujdesi për të krijuar një atmosferë komike e sarkastike në këqyrjen e dukurisë në përgjithësi dhe të ndodhive e karaktereve, në veçanti."<sup>18</sup>

---

18 Papagjoni, Josif. Historia e teatrit Shqiptar. Tiranë , Kristalina-KH, 2011, f.80; 94; 314.

Ajo që vihet re në këtë vënie të parë të Prefektit është krijimi i një loje ansambël, e cila erdhi duke u pasuruar në vëniet e mëvonshme. Duke pasur parasysh që pjesa është një komedi sa situatash aq dhe karakteresh, krijimi i këtyre të fundit me sa më shumë vërtetësi ishte një arritje, ku sigurisht u evidentua figura e Mihal Popit. Trajtimi i skenografisë mbështetëj mbi të vërtetën social-historike në të cilën autori vendos ngjarjet. Në këto vite karakteri përshkruet e informues kundruall mjedisëve historike të kohës ishte i dukshëm, ndaj dhe më i parapëlqyeri nga skenografët e regjisorët.<sup>19</sup>

Si në variantin e parë në Tiranë, me Mihal Popin, ashtu dhe në Durrës, pak muaj më vonë, kur u vu nga regjisori Vlash Beçka, me Nikolin Xhojën, ana spektakolare e shfaqjes apo dhe mënyra e organizimit të së tërës, nuk kishte shumë ndryshim konceptual nga njëra-tjetra. Por, nëse regjisura qëndron në radhë të parë në të drejtuarit e një aktori, të njohjes së botës së tij të brendshme për ta kërkuar e gjetur aty identifikimin me personazhin, atëherë duhet thënë se në këtë drejtim, regjisorët ia kanë dalë. Kur kjo arrihet në mënyrë të suksesshme, atëherë është arritur lidhja autentike njerëzore mes aktorit dhe publikut. Si Mihal Popi, ashtu dhe Nikolin Xhoja, sollën secili dy prefektë të ndryshëm, por po aq të suksesshëm në publik. Duke iu referuar fotove, por dhe bisedat me bashkëkohësit, në këto dy variante ka pak ndryshime si në dekor, ashtu dhe kostume. Por ka ndryshime shumë, sidomos në temporitëm, duke pasur parasysh paraqitjen fizike të Mihal Popit dhe plastikën e Nikolin Xhojës, edhe pse thelbi mbetet po ai.

Ndryshon gjithashtu dhe përqendrimi emocional dhe vetë natyra e ndjenjës së aktorëve. Pasuria e brendshme e këtyre aktorëve varion nga një Prefekt më i rreptë drejt një tjetri pak më "leggero".<sup>20</sup>

---

19 Papagjoni, Josif. Kumti që vjen nga trashëgimia teatrale. Tiranë, ShB Shkenca, 1999, f. 197.

20 Rama, Haxhi. Bisedë për këtë tezë. Durrës, 2017.

Edhe pse shfaqja e parë e Qazim Mulletit kishte një atmosferë elektrizuese, në teatër vërshuan si asnjëherë më parë spektatorë të të gjitha moshave, bile dhe gra shtëpiake të lagjeve, edhe plaka të veshura me çarçaf, siç mbuloheshin në atë kohë<sup>21</sup>, dhe kjo sigurisht u ndie dhe në variantin që u vu në Durrës. Ajo që duhet nënvizuar është periodha në të cilën u vu kjo shfaqje. Teatri profesionist shqiptar ishte në hapat e tij të parë. Regjia si një profesion me traditë të re edhe në arenën botërore, fokusin kryesor duhet thënë se e vinte më shumë në trajtimin e figurave aktoriale, në skicimin sa më të detajuar të secilit prej personazheve. Në këtë rast, figura e regjisorit shkrihej në mjeshtërinë aktoriale. Në variantin e dytë të teatrit të Durrësit, kemi një rishikim të vënies në skenë, një organizim më profesional, ku ndihet një konceptim regjisorial i thjeshtë, i natyrshëm. Regjisorin Panajot Kola, pasi mbaron studimet në BS (Rusi), bën dhe ndryshimet e duhura si në kastin e aktorëve, ashtu dhe në vizatimin e shfaqjes. Në kast luajnë në brezin e parë të aktorëve, disa që kanë mbaruar kursin e aktrimit, e disa të tjerë Institutin e Arteve, ndërkohë që Prefekti vazhdon të luhet nga Nikolin Xhoja. Skenografia e viteve '50, kishte një karakter përshkrues e informues përsa i përket mjedisëve historike të kohës. Me kalimin e viteve karakteri skenografik nga përshkrues kaloi në një karakter shenjues, siç e quan kritikun Josif Papagjoni, pra përfaqësues, sinjifikativ, tipizues, etj.<sup>22</sup>

Te Prefekti në tri variantet e tij kryesorë, vihet re pikërisht kjo ecuri e skenografisë. Dekori në shfaqjen e parë me një stil tejet realist, përshkruan periudhën e dhënë social-historike, mbi të cilën Besim Levonja ka vendosur ngjarjet e komedisë. Në variantin e dytë, vazhdon të ndjehet ky ndikim shëmbëllimi i vendveprimit, por vihet re pëpunimi për t'i dhënë një domethënie që përcjell informacione përgjithëse.

---

21 Arkiva Teatrit Kombëtar. Dosja "Prefekti".

22 Papagjoni, Josif, Kumti që vjen nga trashëgimia teatrore. Tiranë, ShB Shpresa, 1999, f.197.

Në variantin e tretë karakteri shenjues i mjedisëve merr përparësi. Shtëpia e Qazim Mulletit dhe kabineti i tij i punës, janë lehtësuar nga ngarkesa të tepërta në dekore e detaje e po ashtu në rekuizitë. Evidentohet kështu lëvizja skenike e aktorëve, e po ashtu vihet re përpunimi i informacionit historik e social në një gjuhë teatrore të kohës. Varianti i dytë në Tiranë, saktësisht në vitin 1969, sërish nën drejtimin e Andon Panos, ku ndjehet me shumë pak ndryshime në vënien e së tërës, por duke ngulmuar tek loja e aktorit, që ai të zbërthente, të shprehte individualitetin, stilin e tij.

Ndërsa në variantin e fundit kemi një nga regjisorët më të mirë të skenës së regjisorës shqiptare, Pirro Mani, i ndihmuar dhe nga Tef Pali. Është varianti i tij, me Robert Ndrenikën, i cili vazhdon të shihet dhe sot. Nga kritikët kjo vënie është cilësuar si shfaqja ku ndihet uniteti i gjithë elementëve, po ashtu drejtimi i duhur i karaktereve të mëdhenj, jo vetëm Prefekti, Hajria, Mon Kukaleshi, por dhe personazhet e dytë a të tretë, ku përveç kafexhiut, sekretarit, të mbetet në mendje gjer dhe memeci bojaxhi, një rol aq i vogël, por i trajtuar me mjaft mjeshtëri nga Ilia Shyti.

Nëse në një vështrim krahasues mes dy varianteve të fundit, të dy të formuar jashtë vendit, vihet re se Andon Pano është më i “ngadalshëm”, më skrupuloz në krijimin e atmosferës, ndërsa te Pirro Mani, Prefekti duket më i gjallë e energjik. Regjisura e të “mos regjisuarit”, pra të mosndierit të dorës së regjisorit në mënyrë që aktori ta ndiejë në mënyrë autentike atë që personazhi duhet të ndiejë, vihet re në drejtimin e Pirro Manit. Roli i Prefektit me Robert Ndrenikën fitoi një dimension të ri, ndryshe nga ai i Mihal Popit apo Nikolin Xhoxës, por në të njëjtin nivel virtuozyteti. “Duke mos e humbur shkëlqimin e vet, në vënien në skenë nga Pirro Mani, pati një konceptim më kohor, më realist. Nëse te Prefekti i Popit toleroheshin ngjyrat farseske, lodrat e fjalëve dhe nëndialektalizmat, te Nikolini shihet një filoitalian më zotëri, në Prefektin e Ndrenikës ato u retushuan, duke theksuar linjën satirike të figurës qendrore.

Nëse trajtimi i figurës së Prefektit është më grotesk të vënia me Mihal Popin, Pirro Mani ka bërë një trajtim më 'serioz', për ta paraqitur fenomenin ca më të rrezikshëm.<sup>23</sup>

Në skenografi, vihet re një kursim elementësh si në shtëpinë ashtu dhe në zyrën e Qazim Mulletit. Po ashtu nuk është më ajo ngarkesë as në objektet e vendosura e as në rekuzitën personale, duke i vënë të gjitha këto në funksion të lëvizjes së aktorit.

Mizanskena që duken si copëza reale të jetës, vijnë me mjaft natyrshmëri, si te momenti i thyerjes së filxhanit dhe frikës së Prefektit se mos i çahen këmbët, frikë që evidentohet edhe më shumë kur thyhet një pjatë dhe ai fshihet poshtë tavolinës. Ai më kot turfullon e vërtitet në zyrën e vet, me një revolver në dorë, duke u mburrur se "nuk e ha at koqe ullini!" E, nga ana tjetër, kapardiset dhe u mban leksione të tipit ex cathedra fshatarëve në lidhje me të këqijat e komunizmit. Larja e këmbëve në mes të shtëpisë, apo ngrefosja kur vjen e Zonja e Doktorit. Qëndrimi i tij është në kontrast ndryshe me italianët, ndryshe me vartësit e tij. Janë këto gjetje regjisoriale, disa të vendosura enkas me kontrapunkte, që i japin shfaqjes dinamikë komike, e cila, siç thotë kritiku Miho Gjini, "tejshkohet nga humori popullor dhe koloriti kombëtar".<sup>24</sup> Angazhimi ideor e politik në këtë formë duket sikur kalon në plan të fundit.

Nëse mizanskenat te variantet e Andon Panos janë të thjeshta, të qeta e shpesh statike, ku fjala dhe krijimi i një dialogu sa më konkret vihej në plan të parë, pa e rënduar me zhvendosje të tepruara fizike, regjisorët Pirro Mani dhe Tef Pali e kanë konceptuar mjaft mirë pjesën duke krijuar mizanskena të goditura e shprehëse. Hysni Devolli ishte nga skenografët e parë që gjithashtu kreu studimet në Rumani dhe formimi i tij u ndje dhe në konceptimin e hapësirës skenike. Funkcionaliteti ndjehet si në vizatimin e ambientit të zyrës, ashtu dhe në atë të shtëpisë së Prefektit, e cila çon edhe më tej zbrërthimin që regjia i ka bërë personazheve.

23 Papagjoni, Josif. Regjisorët. Tiranë, ShB Albpaper, 2002, f. 49; 61.

24 Intervistë me kritikun Miho Gjini në lidhje me këtë temë. Tiranë, 2017.

Ka ndërthurje madje të stileve të arredimit të shtëpisë; shohim edhe kolltukë modernë, po ashtu edhe minderë dhe shilte. Skenografia në këtë rast kontraston në mënyrë satirike, duke shkuar në unitet me trajtimin regjisorial të shfaqjes. Ky bashkëpunim i ngushtë skenograf-regjisor solli një shfaqje me një vizion të ri.

Edhe kostumet u kuruan po nga Devolli, ku u evidentua ngjyra e zezë e kostumit të Prefektit-Robert Ndrenika, që njëjtësohej me ngjyrën e fashistëve. Te vënia e Andon Panos, shohim se kostumi i Prefektit-Mihal Popi është i njëjtë me atë të djalit të tij, gri me vija (vetëm se te ky i fundit, me pantallona të shkurtra), ndërsa Hajria është veshur me një elegancë të modës italiane, por e tejngarkuar. Te vënia e Panajot Kolës në Durrës, Prefekti është pak më sportiv, ndërsa te Hajria ndjehet mungesa e shijes, gjë e cila është zmadhuar te Hajria që shohim në vënien skenike të Pirro Manit.

Trukimi i personazheve në vënien e Pirro Manit shkon drejt një karikaturizimi, si trashja e vetullave të prefektit, krehja e flokëve të tij në mënyrë komike, apo bigudinat e Hajries, në ndryshim me thjeshtësinë që bie në sy te gruaja e doktorit, vajzës së re, apo te nëna e djalit të futur në burg në fund të shfaqjes.

Një element i rëndësishëm i grimit janë mustaqet, që janë shfrytëzuar si detaj te të tre aktorët. Mihal Popi, mbajti gjithmonë një prerje të flokëve shumë shkurt nga prapa, që të kujtonte, ashtu si mustaqet, Hitlerin; te Nikolin Xhoja u ruajt elementi i mustaqeve, por flokët pak më "modern", ndërkohë që te Robert Ndrenika mustaqet, ashtu si vetullat apo mënyra e flokëve, vijnë të zmadhuara gjer në grotesk. Cullufja e Qazim Mulletit të Robert Ndrenikës në komedinë Prefekti i shëmbëllen lafshës së një gjeli, sepse si gjeli mes pulash sillet edhe personazhi. Si detaj ai është i tipit të ngulitur, i palëvizshëm (i natyrës stacionare) fillim-mbarim, në elementët ravijëzues të "maskës" së aktorit. Megjithatë, ai është një detaj që flet. Detaji është një mjet tepër i rëndësishëm në shfaqjet e Pirro Manit.

Detaje që shprehen përmes disa elementëve të ndryshëm gjatë ecurisë së shfaqjes, duke krijuar kështu një lajtmotiv që e përkshruan atë nga fillimi deri në fund.

“Në vështrimin satirik të figurës së Qazim Mulletit, dinakëria e kuislingut dhe e ‘babait të qytetit’, ka një veshje më të re, nga ku rrezaton një dinjitet fals. Robert Ndrenika luan me ndjenjën e madhështisë e të euforizmit. Te shfaqja e parë ka më shpoti, më shumë përtallje, te shfaqja me Nikolinin më shumë burlesk, tek e treta ka më shumë ironi e sarkazëm. Dhe, kur duhet që ta paraqesë Qazimin në jetën e tij intime, pranë familjes, ku e tërheq për hunde edhe një grua si Hajria e tij injorante, me tipare anadollake që me çdo kusht do t’i adaptohet jetës mondane, ky prefekt i Ndrenikës, pasi heq mantelin e madhështisë, bën një farë prove për ta paraqitur edhe këtu veten si Gjel-kokosh me atë cullufen mbërthyer përpjetë në majë të kokës.”<sup>25</sup>

Skicimi i karaktereve tejet të goditur, jo vetëm i Ndrenikës, por edhe i Behije Çelës si “një kopje e merituar e Qazimit”, apo i Gjon Karmës, “një spiun i regjur, xhelat me të dobëtit, skile me të fortit”, më tutje ai i Kapterit, “një vegël qorre, qen ku leh aty ku han”, apo trajtimi i karakterit të Aliut, “si një Zenel (te komedia Pas Vdekjes e Çajupit) në miniaturë”<sup>26</sup>, janë disa nga veçoritë e zbërthimit të personazheve për të cilët flitet shumë dhe shquhet regjisorja e Pirro Mani. “Këta aktorë karakteresh për mua ishin në nivel evropian!” nënvijëzon vetë ai.<sup>27</sup>

---

25 Gjini, Miho. *Jetë artistësh*. Tiranë, ShB Dituria, 2002, f. 125.

26 Shih: “Platforma regjisoriale e komedisë Prefekti nga Pirro Mani”: Personazhi i Hajries është: “Pa pikën e kulturës dhe të edukatës, por përpiket t’i shesë të dyja. Ziliqare, egoiste, lakmitare... Llapazane dhe frikacake si burri i saj” Arkiva e Teatrit Kombëtar.

27 Papagjoni, Josif. *Biseda për artin*. Tiranë, ShB Botimet Omsca, 2004, f.165. Lexo: “Nuk mund t’i vësh më poshtë p.sh. Totosë, komikut të madh italian. Përgjegjësia ime si regjisor me aktorët ka qënë ngaherë harmonia e tyre me kërkesën time regjisoriale, me personazhin, më gjerazi, me dramën dhe mendimin e saj. Unë kam dashur që të ketë koherencë midis meje dhe aktorit.”

Përqëndrimi emocional dhe vetë natyra e ndjenjës së aktorëve në rol, ka marrë ngjyrime e nuancime të tjera në spektaklin e fundit.

“Krijimi i të veçantës brenda të ‘përbashkëtës’ (pra tri shfaqje me po të njëjtin tekst) është ajo çfarë mund të evidentojmë te trajtimet regjisoriale sa nga njëri tek tjetri, deri tek detajet, në vizatimin e mizanskenës, tek gjestet, në intonacionet foljore,” por duke evidentuar vënien që më shumë i ka rezistuar kohës, asaj të regjisorit të madh Pirro Mani.<sup>28</sup>

## E folura “tironse”

Në thelbin e një komedie qëndron vështrimi kritik ndaj realitetit, i cili trajtohet përmes satirës, ironisë, sarkazmës, humorit e komikes. Te komedia Prefekti kemi qëndrimin kritik ndaj një personazhi, si përfaqësues i gjithë klasës së tij, përmes karikaturizimit, humorit popullor, sarkazmës. Autori ka përdorur një element, me të cilin ka arritur edhe të plotësojë parimet e komedisë së realizmit socialist, edhe të kënaqë publikun: dialektin. Te personazhi kryesor, Prefekti, dallohet në përmasa të zmadhuara përdorimi i dialektit të vjetër tiranës dhe nëndialektalizmat e tij. Ky përdorim, si nga ky personazh, ashtu dhe nga familja e tij dhe njerëzve që e rrethojnë, bëhet me qëllim për të deformuar e stigmatizuar grupet shoqërore prej nga ata vinin, ku e folura në dialekt kishte gati një kuptim negativ e përdorej për të shënjestruar reaksionarët.

---

28 Ndrenika, Robert. “Bisedë me artistin e popullit Robert Ndrenika”. Arkivi i ASA, 1999.

Në komedinë Prefekti, gjuha e personazheve është dhënë në dy grupe:

1. Personazhet që flasin me dialekt: Prefekti, bashkëshortja, djali, shërbyesja, Kafexhiu, Shaqir Aga, katundarët – dialekt tiranas. Në këtë grup veçohet dialekti jugor i Sekretarit, i cili përpiqet të korrigjojë të folurën e trashë të Prefektit.

2. Personazhet që flasin shqipen letrare: Zonja Katerina (e shoqja e doktorit), të arrestuarit, të afërmit e të arrestuarve, komunistët.

Përdorimi i kësaj gjuhe ka ndihmuar për të krijuar karakterizime të ndryshme, ku enkas doza është shtuar te figura qendrore, madje dhe është tejkaluar. Edhe pse nëndialektalizmat ia kanë shtuar akoma më shumë anën farseske pjesës, duke e kthyer kështu në një komedi mjaft popullore, ku ndjehen herë pas here dhe ndikimet e folklorit kombëtar, nga ana tjetër, mund të vërehet aty “tejkalimi i masës së përdorimit të tyre, që e vështirëson komunikimin dinamik të shikuesit”<sup>29</sup> në masë të gjerë. Prefekti përmes gjuhës, identifikohet si një karakter i pazhvilluar, primitiv, lokalist e i prapambetur, duke i shërbyer konceptimit ideologjik kundrejt figurës. “Këtyre aktorëve u duhet të lozin një intelektual, që flet në një nëndialekt, me qëllimin final që figura reale të përqeshet në vrugun e injorancës, sikundër është e mbushur me zhargonin ‘tiron’, efekte nga të cilat, që të tre aktorët tanë të shquar interpretues, nuk janë shmangur dot.”<sup>30</sup>

---

29 Shih: Rexhaj, Besim. Drama shqiptare pas Luftës së dytë Botërore. Prishtinë, ShB Faik Konica, 2009, f. 213: “Duke e projektuar gjuhën dialektale të personazhit në funksion të karakterizimit të tij, autori ka humbur sensin e masës kur këtij karakteri dialektal ia ka bashkëngjitur edhe karakterin defetuoze në shqiptimet fonetike, shtrëmbërimi i të cilave rezultoi si pengesë komunikimi ose si amortizim i këtij komunikimi.”

30 Gjini, Miho. Artisti i Popullit Nikolin Xhoja. Tiranë, ShB Edlora, 2015, f. 74.

Më së shumti nëndialektin e rëndë tiranas e shfrytëzoi Mihal Popi, madje duke krijuar shumë detaje, gjetje e theksa komikë të fjalëve, ndërkohë që Pirro Mani nënvizon në platformën e tij regjisoriale se: “Kemi synim që në spektaklin tonë, karakteri zhargonesk dhe farsesk të interpretohen në masa më të përmbajtura.”<sup>31</sup>

Parodizimi i personazhit të Prefektit, përmes gjuhës, shpesh ka çuar në përfundimin se suksesi i tij qëndron pikërisht tek e folura e trashë tiranase, edhe pse shkrimtari e dramaturgu Kolë Jakova e hedh poshtë duke thënë se: “Të folurit i jep kolorit gazmor veprës, por jo se është faktor kryesor i këtij gazi. Vepra e ka të qeshurin brenda në vetë situatat, në vetë ngjarjet dhe në vetë zhvillimin aktiv të tyre.”<sup>32</sup>

Megjithatë fakt është se shumë prej batutave të Prefektit janë ato që futen shpesh në biseda të përditshme edhe në ditët tona.

## Prefekti i Popit, i Xhojës, i Ndrenikës

Pse një aktor në një rol mund të të befasojë dhe një tjetër në të njëjtin rol nuk të jep as emocionin më të vogël, në të njëjtën pjesë me të njëjtin rol? Fjalët e tekstit janë po ato, por mënyra sesi përcillen nga aktorët, të cilët drejtohen nga regjisorët në zgjedhjet dhe trajtimet që bëjnë, arrijnë të sjellin karaktere që e prekin aq shumë publikun duke mbetur kështu përherë në kujtesën e tij.

---

31 Mani, Pirro. “Platforma regjisoriale e komedisë Prefekti”. Arkiva e Teatrit Kombëtar.

32 Jakova, Kolë. “Shfaqje që mbetet premierë”. Drita, nr.1332 (maj 1986). Tiranë, f.12.

Lidhja njerëzore, siç thotë regjisori madh Piter Bruk, është esenca e teatrit të mirë. Kështu ka ndodhur me Mihal Popin, me Nikolin Xhojen, kështu ndodh me Robert Ndrenikën.

Tre Prefektë në tri lojëra aktoriale të ndryshme. Secili prej tyre ka kostumin e vet. "Qazim Mulleti duket si një trinitet i rrallë në analet e teatrit."<sup>33</sup>

"I njëjti Qazim, pra i krijuar nga pena e Besim Levonjës, na vjen si një personazh tipik i individualizuar. Ne themi Prefekti i Popit, i Xhojës, i Ndrenikës. Një individualizim konkret, i shprehur në tri trajta, me skicime të imëta aktoriale, brenda vetive të personazhit si karakter artistik i papërsëritshëm. Loja aktoriale lë aty vulën e individualitetit njerëzor e krijues të çdonjërit prej tyre."<sup>34</sup>

Duke qenë një komedi karakteresh, zbërthimi i personazheve lidhet me trajtimin e stilit të dramës nga autori, të shfaqjes nga regjisori e të rolit nga vetë aktori. "Në qendër të kësaj komedie, ngado që të sillemi, kemi në qendër një protagonist, një figurë dominante, kështu barra dhe rëndësia e trajtimit të pjesës është mbështetur pikërisht në përzgjedhjen e aktorit kryesor."<sup>35</sup>

Mihail Popi aktivitetin e tij artistik e filloi në teatër në vitin 1924 në Tiranë, me grupet amatore, me mbi 40 role, ku spikat roli i Prefektit, të cilin ai e ka luajtur 106 herë. Edhe pse roli i Prefektit e bëri tepër të njohur duke i dhënë emrin madje si aktori komik më i veçantë dhe më brilant i teatrit shqiptar, në një intervistë të vitit në 1974 me studentë e pedagogë të Institutit të Arteve (sot Universiteti i Arteve), Mihal Popi thotë se: "Qazimi më është dukur më i vështiri nga të gjithë rolet. Pas çdo shfaqje të re unë nuk flija, përpiqesha të gjeja detaje të reja. Unë nuk kam luajtur asnjëherë komedinë e personazhit, por dramën e tij. Me Qazimin ndërroja tri këmishë me djersë për çdo shfaqje, kisha dramë, kisha vërtet hall, kurse publiku qeshte."<sup>36</sup>

33 Papagjoni, Josif. Biseda për artin. Tiranë, Botimet Omsca, 2003, f. 294.

34 Papagjoni, Josif. Aktorët. Tiranë, SHBLU, 1999, f. 62.

35 Gjini, Miho. Monografi: Artisti i Popullit Nikolin Xhoja. Tiranë, ShB Edlora, 2015, f. 74.

36 "Mihal Popi: Si më ndihmoi punëtori i Qazimit për rolin": <http://www.panorama.com>.

Partnerja e M. Popit, Behije Çela thotë se Qazim Mulleti i Mihal Popit qe një tip qesharak, por ai kurrë nuk ka luajtur për të qeshur. “Mihali interpretonte me kaq seriozitet sa të vinte ta urreje me gjithë mend”<sup>37</sup>

Mihal Popi ka dhënë një “dramë qesharake” të mirëbalancuar. Me një lojë të sinqertë të ndjenjës komike ai mishëron një prefekt që nuk e humb peshën vetëm duke u bërë qesharak, dhe as nuk e ka humbur nurin komik, mungesa e të cilit do të çonte në skematizimin e personazhit. Si një aktor i përjetimit emocional, ai kthehet në atë që personazhi duhet të jesh ti dhe jo ta luash atë. Mihal Popi na e jep rolin falë një përqendrimi të madh ideoemocional. “Muzika ka një notë të plotë, të madhe, që i thonë 4/4,” argumenton Popi. “Ajo ndahet në gjysmë, në çerek, në tetëshe, gjashtëmbëdhjetëshe etj. E prej kësaj krijon melodi. Edhe në teatër aktori ‘ka hallin’. Por ky hall ndahet në copa të ndryshme. Çfarë halli ka aktori kur del në skenë? Kjo është nota e tij e plotë. Kjo ndahet tani: Ku qe? Nga ishe? Çfarë bëre? Çfarë kërkon? Çfarë do? Këto janë notat e vogla, në qoftë se mund t’i quajmë kështu.

Para se të hyja në skenë i thosha vetes: Ç’hall ke?”<sup>38</sup>

Nikolin Xhoja, i cili lindi në Brindisi të Italisë, njësoj si Mihal Popi<sup>39</sup>, e nisi angazhimin e tij me teatrin në grupet teatrore të njësiteve luftarake.

Në grupin flodramatik partizan në Kosovë, si një ndër

[com.al/mihal-popi-si-me-ndihmoi-punetori-i-qazimit-per-rolin/](http://com.al/mihal-popi-si-me-ndihmoi-punetori-i-qazimit-per-rolin/). Parë më 20 mars 2019.

37 Papagjoni, Josif. Aktorët. Tiranë, SHBLU, 1999, f. 134.

38 Po aty.

39 Intervistë me regjisorin, përkthyesin dhe libretistin Gjergj Vlashi mbi këtë temë: “Ajo që duhet evidentuar në lojën e dy protagonistëve të parë të këtij kryeroli, është se si Mihal Popi ashtu dhe Nikolin Xhoja vinin të dy nga lëvizja amatore dhe teatri partizan, e për vetë kushtet në të cilat ishte Shqipëria në periudhën e pas Luftës, nuk kishin kualifikimin e duhur shkollor, le të themi profesional, por karakteristikat e mjeshtërisë së tyre aktoriale i kalonin të gjithë izmat akademikë. ‘Shpesh kur punoja me këta emra të mëdhenj ndihesha paksa në siklet, – kujton regjisorin Gjergj Vlashi, – pasi duhet të mendohesha dy herë kur u bëja sugjerime lidhur me rolin. Ata ishin të mëdhenj në gjininë e tyre e prej tyre mësoje shumë. Ata nuk kishin bërë shkollë, por ata krijuan shkollë.”

aktoret kryesorë të njësisë ushtarake, dha shumë shfaqje në qytetet e Gjakovës, Sanxhakut, Mitrovicës, Gostivarit, Ohrit, etj. Pas çlirimit kthehet në Durrës dhe bëhet një nga aktorët themelues të teatrit “Aleksandër Moisiu”, ku numëron mbi 54 role, por shquhet për rolin e Prefektit.

Regjisori për të shprehur me forcë idenë e veprës, – siç shprehet Pirro Mani, – duhet ta drejtojë aktorin për një punë organike në mishërimin e figurës. Dhe një aktor i cili vlerësohet për organicitetin e tij të vepruarit në skenë dhe për një fizionomi vetjake që ai i jepte secilit rol, është Nikolin Xhoja. Te Prefekti, Nikolin Xhoja ka lënë në Durrës po aq mbresa saç ka lënë Mihal Popi në Tiranë. “Ai është i pranishëm në skenë, nuk bërtet ‘Ja si jam unë, ja si bëj unë.’ Përkundrazi ai merret me diçka të parëndësishme, syri i spektatorit mbetet aty, tek ‘ai’. Skena shihet nga ai si mjedisi i natyrshëm i aktorit si artist.”<sup>40</sup> Duke u ndalur në veçoritë e këtij aktori, si dhe në mishërimin që i bëri figurës së Prefektit, edhe kritiku i artit që është marrë në veçanti me figurën e aktorit Nikolin Xhoja, Miho Gjini nënvizon: “Nikolin Xhoja krijon një Prefekt, i cili e sheh veten të privilegjuar, si pinjoll i atyre italianëve, që thonin shpesh aforizmën e Duçes ‘Shqipëria është në zemrën time!’, me një paraqitje më të pranueshme, paksa më larg groteskut të komediografit. Ai i jep figurës së Prefektit, jo vetëm rëndësinë e postit që mban, por edhe elegancën e njeriut të kulturuar, me etikën e vet, që i shton rolit si aktor. Pikërisht ky tip prefekti filoitalian i ra për short një aktori me origjinë italiane, sikundër ishte realisht Nikolin Xhoja! Ai ishte në skenë si një njeri-aktor, që vjen direkt nga rruga, pa shtirje, pa grimasa teatrale dhe gjithmonë elegant, me një humor.”<sup>41</sup>

---

40 Papagjoni, Josif. Aktorët. Tiranë, SHBLU, 1999, f. 174.

41 Gjini, Miho. Monografi, Artisti i Popullit Nikolin Xhoja. Tiranë, ShB Edlora, 2015, f. 75.

Te ky aktor vihet re mjeshtëria e tij, larg teatralitetit, duke krijuar një personazh origjinal e mjaft organik. "Xhoja që si aktor një nga modelet e para të neorealizmit shqiptar, nëse na lejohet të paralelizojmë me atë italian të kohës, në artin e interpretimit, për sa i përket vërtetësisë së jashtëzakonshme, si edhe mjeshtëri i përsosur i humorit skenik shqiptar në periudhën e neorealizmit italian, nga njëra anë dhe të realizmit socialist, nga ana tjetër, duke zgjedhur me zgjuarsi e talent 'rrugëtimin e ndërmjetëm'."<sup>42</sup> Madje duke i parë sot të tre Prefektët, nga kjo distancë kohore, kritikë M. Gjini është i mendimit se: "Në trajtimin artistik, që i ka bërë rolin të Prefektit Nikolin Xhoja, duket se është më i sakti e më i afërti me konceptin bashkëkohor."<sup>43</sup>

Aktori i tretë që iu caktua ta vazhdojë më tej figurën e Prefektit ishte Robert Ndrenika. Ai mbaron studimet në Shkollën e Lartë "Aleksandër Moisiu". Është aktori me ngarkesën më të madhe në teatrin dhe kinematografinë shqiptare. Ndrenika krijoi një prefekt ndryshe nga Mihal Popi. Robert Ndrenika nënvizoi anën dramatike duke krijuar situata që ndryshonin nga dy prefektët e mëparshëm. "Në lojën e tij binte në sy plastika e goditur dhe kur ai ecte nëpër skenë ngjante sikur i shtypte partnerët e tjerë."<sup>44</sup> "Bashkë me Pirro Manin ne deshëm t'i jepnim peshë, rëndësi, autoritet Qazimit; të të mbushej mendja që ky njeri është vërtet një Prefekt, që ai edhe ta bën gjëmën, edhe të burgos, sikundër edhe trembet."<sup>45</sup> Psikofiziku i tij është në unitet: ashtu siç shfaqet në ecje e lëvizje, ashtu edhe në të folur e reagime. Ne arrijmë të shohim një personazh ku mospërputhja e brendshme e karakterit krijon mjaft komicitet. Pirro Mani që në platformë e ka perceptuar Prefektin: "Edhe të egër dhe frikacak, edhe dinak dhe budalla.

---

42 Shih po aty. "Ashtu si shumë artistë shqiptarë që i mbijetuan sistemit komunist, edhe Nikolin Xhoja, gjenin edhe 'shtigje' shpëtimë prej 'vorbullës' absurde. Vlera e artit të Nikolin Xhojës është shëmbëlltyra më e lartë, se si mund të 'operohet' skenikisht, me metoda inteligjente të Mjeshtërisë së Aktorit, për të thënë (në këtë 'vorbull'), jo vetëm realitetin, po edhe qëndrimin e sfidën vetjake, si obsion estetik e artistik." F. 74

43 Shih po aty.

44 Vlasi, Gjergj. Intervistë për këtë temë. Coruna, Spanjë, 2017.

45 Papagjoni, Josif. Biseda për artin. Tiranë, Botimet Omsca, 2004, f. 295.

Pseudokultura e tij, megjithëse mundohet ta fshehtë, manifestohet në të gjitha marrëdhëniet e tij me partnerët, duke zbuluar kështu fytyrën e tij të vërtetë prej anadollaku.<sup>46</sup> Ai nuk ka dyshime në përzgjedhjen për Prefektin, duke ia besuar një aktori që di të luajë si Harpagonin, si Falstafin, me të njëjtën mjeshhtëri si Qazim Mulletin. Për të, Robert Ndrenika është një aktor poliedrik, luan në të gjitha planet, është inteligjent, transformohet, përdor mrekullisht dialektet, plastikisht është i ndërrueshëm, është shumë i madh për të dëgjuar me vërtetësi. Bëje si të duash, ndërron trajtë pa vështirësi, si brumi.<sup>47</sup> Gërshetimi i sarkazmës me humorin e farsën e bën atë një aktor unik në skenën shqiptare.

“Me një gjuhë realiste ai solli figurën e Qazim Mulletit, ku aktrimi i tij u dallua për ‘seriozitetin’ dhe ‘rëndësinë’ që i dha këtij personazhi nga fushëpamja e mbartjes komike, duke e mbajtur gjithëherit brenda tonimeve të një satire të mprehtë.”<sup>48</sup>

Një veçori e përbashkët e këtyre aktorëve (secili brenda kontekstit të figurës që kishte krijuar) është improvizimi. Në lojën e Mihal Popit vihej re në masë<sup>49</sup>, por po ashtu dhe te Nikolin Xhoja ka po aq shtime teksti e batutash si “Të ndalojmë fiqtë të piqen,” për të dëshmuar komicitetin dhe alogjizmin e personazhit, talljen dhe satirizimin ekstrem, ashtu dhe Ndrenika nuk mbetet më pas. Ai krijon një grafik që duket që është i studiuar, plot të papritura, ndërkohë që ndërton dy komunikime paralele; edhe me partnerin dhe po ashtu me publikun.

---

46 “Platforma regjisoriale e komedisë Prefekti, nga Pirro Mani”. Arkiva e Teatrit Kombëtar.

47 Papagjoni, Josif. Biseda për artin. Tiranë, Botimet Omsca, 2004, f. 160.

48 Papagjoni, Josif. Historia e teatrit Shqiptar. Tiranë, Kristalina-KH, 2011, f. 94.

49 “Mihal Popi: Si më ndihmoi punëtori i Qazimit për rolin”: <http://www.panorama.com.al/mihal-popi-si-me-ndihmoi-punetori-i-qazimit-per-rolin/>: “Teksti i sotëm i Qazimit, siç thoshte Besimi (Levonja) ka autor kolektivin, ose më mirë Mihal Popin. Ai kënaqej se unë çdo mbrëmje bëja pastrim dhe riparim të tekstit. Kishim sufler Tef Palin, dhe gjatë shfaqjes unë interpretoja, ai mbante shënim. Pas nja njëzet a tridhjetë shfaqjesh, na doli tekst i ri, të cilin e pranoi dhe vetë autori.” Parë më 20 mars 2019.

Duke i vënë përballë të tre këta aktorë, secili në rolet përkatës, individualiteti i tyre spikat dukshëm: "Aktori potencial Mihal Popi na ka dhënë një 'derr të egër', që bie në 'kurthin e ngritur' të komunistëve dhe është më në afërsi me aspektin e trillimit komik të figurës, aktori elegant Robert Ndrenika na ka dhënë një 'birbo të pispillosur' që ka frikë se mos humbet privilegjet e tij, aktori organik Nikolin Xhoja krijon një prefekt mes këtyre dy alternativave, duke na sjellë një prefekt filoitalian!"<sup>50</sup>

Ekuivalenca emocionale midis aktorit dhe personazhit lidhet me nuanca të caktuara të qëndrimit ideor të aktorit ndal rolit, me natyrën e ndjenjës së tij, e cila kushtëzohet nga triniteti: autor – regjisor – aktor. "Te Prefekti i Mihal Popit aty aktori sikur thotë: 'Prefekti jam unë.' Kurse te Prefekti i Robert Ndrenikës, duket sikur thotë: 'Prefekti është ky!'"<sup>51</sup> Pra nëse te loja aktoriale e M. Popit ndjehet loja realiste, e mishërimit të drejtpërdrejtë të personazhit si në jetë, te Ndrenika kemi një lojë të distancimit, më të kualifikuar. Pyetja që vazhdimisht shtrohet është se cili nga këta tre aktorë realizoi Prefektin më të mirë, e përgjigjet mund të jenë subjektive, por në fund do të biem të gjithë dakord me regjisorin Vlasi: "Mendoj se është e vështirë të përcaktosh se cili qe më i miri. Mendoj se të tre krijuan një figurë që është e vështirë të harrohet. Madje duke analizuar figurat e tjera nuk ke si të mos habitesh për disa role të dyta apo të treta që lanë mbresë gjatë shfaqjes. Mund të përmendim edhe ndonjë fshatar të pjesës që vinte në lojë prefektin me humorin e tyre të hollë si i ndjeri Tod Thanasi në rolin e Liut . Edhe figura e Hajries, gruas së prefektit sillte mjaft freski në secilën nga vëniet, por unë këtu do veçoja dyshen nga Nikolin Xhoja e Meropi Xhoja, një duet që nuk harrohet kollaj. Gjithsesi komedia, duke qenë komedi karakteresh, duhet thënë se në tri vëniet them se i shpëtonte loja e tre aktorëve.

Komediografia shqiptare ka me çfarë të mburret për lojën e këtyre mjeshtrave të mëdhenj."<sup>52</sup>

---

50 Gjini, Miho. Monografi, Artisti i Popullit Nikolin Xhoja. Tiranë, ShB Edlora, 2015, f. 75.

51 Papagjoni, Josif. Aktorët. Tiranë, SHBLU, 1999 f. 140.

52 Vlasi, Gjergj. Intervistë për këtë temë. Coruna, Spanjë, 2017.

## Prefekti sot

Demistifikimi i pushtetit është një nga temat kryesore që e bëjnë këtë komedi një ndër veprat e pakta të letërsisë së realizmit socialist që edhe të ribotohet si tekst, por edhe kaq shumë e rivënë në skenë. Problemi i masave me hierarkinë e pushtetit e sjell atë më pranë kohës. Veshja e tyre me të meta e kufizime, mashtrime e babëzi, edhe pse në shfaqje vjen, për shkak të pozicionimit ideologjik të kohës, mjaft e karikatizuar, gjithsesi e bën paralelizmin me realitetin e sotëm mjaft evident. Vlera e tekstit së kësaj komedie qëndron si në humorin dhe karakterizimin që i është bërë çdo personazhi, ashtu edhe në një rikodifikim të tij pas viteve '90. Prefekti na vjen sot si një tekst profetik, i cili në atë kohë dëshmoi disa të vërteta. Nëse në atë kohë, personazhi kryesor, "inJORanti", diku thotë: "Sa farë e keqe qeka komunizmi!", një ide kjo që, mbase, ishte e vërtetë qysh atëherë, pra ishte e besueshme për shumicën. Por diku tjetër po ky prefekt thotë: "Ju nuk doni këtë qeveri, por ajo që do vijë do të jetë më e keqe se sa kjo që keni sot; do ikni nga shiu, do bini në breshër."<sup>53</sup> E pra, këtë personazh që e sheh komunizmin si një sëmundje, sot fjalë të tilla nuk e bëjnë aspak më një inJORant, por goja e tij duket se ka shqiptuar fjalë profetike.

---

53

Papagjoni, Josif. Biseda për artin. Tiranë, Botimet Omsca, 2004, f.295.